



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:031540

Datë: 22.03.2021

Numri i dokumentit: 01618511

P.nr. 102/20

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me praktikantin Faton Kokollari në lëndën penale kundër të akuzuarve T. Sh. dhe A. Sh. që të dy nga fshati Mushtisht, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 te KP. e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.271-11/20 të dt.28.02.2020, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.18.03.2021, në prezencë të PSH Atnor Skoro, të akuzuarve dhe mbrojtësve av. I. K. dhe av G. K., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me daten 22.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

1. T. Sh., nga i ati N. e ëma L. mbiemri i vajzërisë Th., i lindur me datë 27.10.1998 në Gjermani, tani me vendbanim n M. , Komuna e Suharekës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punëtorë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pajisur me letërnjoftim me nr. personal:
2. A. Sh., nga i ati S. e ëma Xh. mbiemri i vajzërisë J., i lindur me datë 24.08.1999 në Zvicërr, tani me vendbanim në fshatin M., Komuna e Suharekës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punëtorë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pajisur me letërnjoftim me nr. personal:

JANË FAJTOR

Se me datë 29.01.2020 rreth orës 22,40 minuta në Suharekë, në fshatin S. Komuna e Suharekës, të pandehurit T. Sh. dhe A. Sh., posedojnë pa autorizim narkotik, në atë menyrë gjatë një kontrolli rutinor të bërë nga ana e policis, ndalet vetura e markës BMW X., ngjyrë e zezë të cilën e drejtonte i pandehuri A. Sh., kurse i pandehuri T. Sh. ishte pasagjerë dhe gjatë kontrollit të bërë në veturë, tek të pandehurit gjenden 1 (një) pako rizlla me mbishkrim "OCB SLIM", të cilën e konsumonin të njejtit e të cilat sekuestrohen nga ana e policis.

Me këto veprime në bashkëkryrje kanë kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 te KP.

Pranohet marrveshja mbi pranimin e fajsis PP/II.nr.271-11/20 të dt. 28.02.2020 e lidhur mes prokurorit te Shtetit - Prokuroris Themelore në Prizren e nënshkruar nga Kryeprokurori i Prokuroris Themelore dhe prokurori i qështjes në njëren anë dhe të akuzuarve T. Sh. dhe mbrojtësit av. I. K. dhe A. Sh. dhe avokatit G. K. , në anën tjetër.

Andaj gjykata ne perputhje me nenin 38,39,40,43,69,70, 269 par. 2 te KP dhe nenet 365,450 te KPP, të akuzuarit i:

G J Y K O N

Të akuzuarin T. Sh. me denimin me gjobë në shumë prej **250 € (dyqind e pesëdhjetë Euro)**, të cilin denim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi, poqëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me denim burgimi **prej 12 ditësh**, duke llogaritur për 20 € gjobë me një ditë burg.

Të akuzuarin A. Sh. me denimin me gjobë në shumë prej **250 € (dyqind e pesëdhjetë Euro)**, të cilin denim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmëris se këtij aktgjykimi, poqëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me denim burgimi **prej 12 ditësh**, duke llogaritur për 20 €, gjobë me një ditë burg.

Obligohen të akuzuarit me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën me nga 20 € dhe taksës për kompensim të viktimave të krimit shumën me nga 30 € (veq e veq).

Substanca narkotike e llojit marihuan në peshë 0,40 gram konfiskohet.

A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr. 271-11/20 të dt. 28.02.2020, ka akuzuar T. Sh. dhe A. Sh. që të dy nga fshati M., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 te KP, aktakuzën të cilin gjate séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e tij e ka përfaqësuar PSH Atnor Skoro e cila në tërësi ngel pran të dhënave si në aktakuzë që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, e në përputhje me marrveshjen mbi pranimin e fajsis e cila i është bashkangjitur aktakuzës.

Të akuzuarit në këtë qështje penale i kanë mbrojtur av.I. K. dhe av. G. K., të cilet në seancë për shqyrtimin e marrveshjes kanë deklaruar se marrveshja është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, pa kurrfar ndërhyrje apo shtytje nga jashtë, pos vullnetit të lirë të shprehur nga vetë i akuzuari, andaj në përputhje me atë marrëveshje, kërkojm nga gjykata të akuzuarit ti shpallë fajtor dhe ti denoi në përputhje me denimin e rekomanduar në marrveshtje.

Të akuzuarit gjithashtu në seancën për shqyrtimin e marrveshjes për pranim të fajsis kanë deklaruar se kanë qenë të vetëdijshëm, të informuar me benificionet dhe pasojat e nënshkrimit të kësaj marrveshje dhe se me vullnetin e lirë në prani të mbrojtësve e kanë nënshkruar të njejtën dhe kanë heq dorë nga një gjykim i rregullt, ku do të administroheshin provat, në shkëmbim të një denimi me të butë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.18.03.2021 degjoi palet, ku PSH ngeli si ne aktakuzë dhe kërkoi nga gjykata të aprovoi marrveshjen mbi pranimin e fajsis dhe të akuzuarve ti shqiptoi denimin e propozuar në marrveshje të rekomanduar në piken IV të marrveshjes, pasi që marrveshtja është nënshkruar me vullnetin e palëve dhe është në përputhje me nenin 233 pika 18 e KPP.

Të akuzuarit dhe avokatët e tyre gjithashtu kërkuan që gjykata të aprovon marrveshjen dhe tui shqipton denimin e rekomanduar në piken IV të saj.

Gjykata ka vlersuar se marrveshja të pranohet pasi që e njëjta është në përputhje edhe me provat materiale që i janë bashkangjitur aktakuzës nga Prokuroria e Shtetit dhe se e njëjta nuk është në kundërshtim me paragrafin 18 të nenit 233 të KPP dhe ka shqiptuar denimin e rekomanduar si në marrveshje.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 450 të KPP.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:031540, 22.03.2021

G j y q t a r i

Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.